



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

623-26-2185-2-2-1/C710

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K.; E-Commerce - Kosova SH.P.K., Sheshi Ilmi Maliqi, RAHOVEC, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i Kontratës: **Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"**

Me numër identifikues: **623-26-2185-2-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"

<i>Nr.</i>	<i>Grupi</i>
1	Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorjshërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 36 Muajsh

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë...ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **Në objektet e Komunës së Rahovecit**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës për njësi është: **1,308.13 Euro**. [Një mijë e treqindetë Euro e tremdhjetë Cent]

Vlera totale indikative e kontratës është: **50,000.00 Euro**; [Pesëdhjetë mijë Euro]

Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është: plus/minus +/- 30%

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën: Shqipe¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Ofruesin e Shërbimeve:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Petrit Veliu
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10.06.2026	Data:	10.06.2026
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjyrimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrorit. Ekzekutimi i urdhrorit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 **Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 **Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 **Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshtëpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshtëpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshtëpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

623-26-2185-2-2-1/C710

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është me datën e nënshkrimit të Kontratës
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është: Në objektet e Komunës së Rahovecit
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA)
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është: 10 % e Çmimit final të Kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 37 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. b) Përgjegjësia e palës së tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. d) Përgjegjësia profesionale: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues, pas dorëzimit të procesit të pranimit të shërbimeve të kryera dhe faturës Orari i pagesës do të jetë: Për çdo muaj pas dorëzimit të raportit të pranimit të shërbimeve nga Menaxhi i Kontratës
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i projektit i caktuar me vendim nga Zyrtar Kryesor Administrativ
Garancioni për materialet		Operatori Ekonomik garanton se materialet e përdorura janë bio dhe të atestuara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Ne, **Gzimi Garten und Landschaftsbau Sh.P.K.**, në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për projektin “**Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive ‘Mizahir Isma’**”, me numër të prokurimit **623-26-2185-2-2-1** dhe numër të brendshëm **623-26-009-2-2-1**, deklarojmë nën përgjegjësi të plotë materiale dhe ligjore se të gjitha produktet dhe materialet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës janë **ekologjike, të atestuara dhe në përputhje të plotë me standardet teknike, normat e cilësisë dhe legjislacionin në fuqi.**

Kjo deklaratë lëshohet për qëllime të pjesëmarrjes dhe vlerësimit në procedurën e lartcekur të prokurimit dhe mban përgjegjësi të plotë juridike për saktësinë e të dhënave të paraqitura.

Data: 04.05.2026

Vendi: Rahovec

Për Operatorin Ekonomik:
Gzimi Garten und Landschaftsbau Sh.P.K.



Deklarate me shkrim për realizimin e shërbimeve sipas specifikimeve teknike Aneksi 1 ne Dosjen e tenderit;

Une, poshtë i nenshkruari, Petrit Veliu si drejtues ekzekutiv i kompanise **GZIMI GARTEN UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K** per realizimin e projektit te publikuar nga **Kuvendi Komunal Rahovec** me titull: **Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"** me nr te prokurimit **623-26-2185-2-2-1** deklarojme se i kemi shqyrtuar specifikimet teknike te detyrueshme dhe j'u sigurojme se do i permbushim te gjitha specifikat sipas Aneksi 1 ne Dosjen e tenderit.

Deklaroj se i permbush specifikimet teknike te detyrueshme sipas Aneksi 1 dosjes se tenderit per projektin:

Mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe Palestra Sportive "Mizahir Isma"

Investitori: **Kuvendi Komunal Rahovec**

Numri i Prokurimit : **623-26-2185-2-2-1**

GZIMI GARTEN UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K _____

Më datë: **04.05.2026**



Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Kërkohet përzgjedhja e një OE që do të bëjë pastrimin e objektit të Palestrës së sportit "Mizahir Isma" në Rahovec. Sasia e shënuar më poshtë është sasi e përafërt dhe çmimet kërkohen për njësi.

Përshkrimi teknik i punëve për pastrimin e objekteve bëhet:

SHTOJCA A
Shërbimet e pastrimit

Pastruesja/si – Kryen shërbime të pastrimit, pastrimin e zyreve, inventarit, pajisjeve (kompjuter, printer, çdo objekt që ndodhet në hapësirën e Palestrës), korridoret, shkallët, dyshemenë, etj.

Pastrimi fillestar

Pa marrë parasysh shpeshtësinë e pastrimit, kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha detyrat e pastrimit të dhëna në listën e shërbimeve të pastrimit në afat prej 30 ditëve, që të sigurojë pastërti standarde të llogaritur që nga fillimi. Pas kësaj (pastrimit fillestar) kontraktuesi duhet të kryejë shërbimet e pastrimit sipas intervaleve të dhëna. Kontraktuesi duhet të përfshijë çmimin e pastrimit fillesatar në çmimin për metër katror për muaj.

Detyrat ditore

Intervalet për kryerjen e detyrave ditore nuk janë të caktuara. Kontraktori është përgjegjës që të përkujdeset që këto hapësira të jenë të pastëra në çdo kohë, sipas standardeve të mëposhtme. Është përgjegjësi e punëkryesit të kujdeset që këto standarde të respektohen, duke rregulluar intervalin e pastrimit sipas nevojës gjatë tërë ditës, për të siguruar shërbim efikas dhe të pandërprerë.

Pastrimi i dyshemesë

Pastrimi i Përgjithshëm: Pas kryerjes së pastrimit të dyshemesë, dyshemeja duhet të lihet në gjendjen e parashikuar sipas kërkesave teknike të mirëmbajtjes së dyshemesë. Pastrimi duhet të kryhet në të gjitha sferat; përfshirë këndet, hapësirat prapa dyerve dhe nën inventar ee pajisje. Mobiljet dhe pajisjet mund të zhvendosen gjatë procesit të pastrimit dhe të kthehen në vendin fillestar pasi të kryhet pastrimi. Karriget asnjëherë nuk duhet të vendosen në tavolina ose tryeza. Pastrimi i tapeteve të dyshemeve dhe ato kundër rrëshqitjes, duhet të kryhet çdo herë kur pastrohet, fshihet ose lahet dyshemeja.

Të gjitha mbeturinat duhet të vendosen në shporta të mbeturinave. Shenjat paralajmëruese "sipërfaqja e lagësht", duhet të vendosen në vendet e dukshme në të gjitha katet dhe/ose korridoret gjatë procesit të pastrimit dhe duhet të largohen sapo të thahen sipërfaqet.

Pastrimi i dyshemeve në vend: Pastrimi në vend (sipas rastit) definohet si largim me dorë, pastrim, fshirje me leckë të lagur ose pastrim me fshesë elektrike të hapësirave të vogla për të larguar mbetjet, lëngjet, njollat dhe/ose mbeturinat. Pastrimi në vend përfshin largimin e ujit, papastërtisë, rërës, njollave të shkaktuara nga hapjet e dyerve në vendet me qarkullim të madh.

Fshirja. Fshirja duhet të kryhet me anë të fshesave, brushave, leckave të pluhurit dhe fshiseve elektrike. Dyshemeja konsiderohet e pastër kur nuk ka mbeturina, pluhur të dukshëm, guriçka, njolla dhe mbeturina të ushqimit.

Pastrimi me fshesë elektrike: Pastrimi me fshesë elektrike kryhet me rrahësin mekanik ose fshesën elektrike pa zhurmë, për pastrimin e tapeteve, thithësen në formë brushe. Tapeti konsiderohet i pastruar kur nuk përmban mbeturina dhe copëza dheu në të.



Fshirja me leckë të njomë: Fshirja me leckë nevojitet për të pastruar hapësirat e dyshemesë së drurit kur pastrimi i lagësht nuk është i lejueshëm. Pas fshirjes, pastrimi i njomë mund të arrihet duke shfrytëzuar leckën e njomur në tretje detergjenti/dezinfektuesi dhe shtrydhja e saj deri sa të jetë e lagur. Dyshemeja e pastruar mirë me leckë është ajo që nuk ka pluhur, shenja, cipë të hollë pluhuri, vija të ndryshme, mbeturina dhe ujë të mbetur.

Pastrimi me leckë plotësisht të lagur: Pastrimi me leckë të lagur vjen pas fshirjes dhe bëhet në hapësirat që nuk kanë tapete ose dysheme të drurit, duke shfrytëzuar lecka pambuku ose shpuzë. Leckat zhyten më shpesh në ujë të pastër dhe tretje detergjenti dhe/ose dezinfektuesi për të lagur dheun. Dyshemetë pastaj shpërlahen me leckë të njomë për të larguar të mbeturat e pastrimit të lagësht dhe ujin e tepërt.

Hedhja dhe pastrimi i mbeturinave

Kontejnerët e mbeturinave janë ato që shfrytëzohen për të hedhur mbeturinat e zyrës, e shpuzorët dhe enët tjera të duhanit. Kontejnerët e mbeturinave duhet të zbrazen dhe të lahen me shpuzë ose leckë të zhytur në tretje detergjenti. Kontejnerët e fshirë nuk duhet të përmbajnë pluhur, papastërti, njolla ose mbeturina. Kontejnerët e mbeturinave duhet të hudhen në kontejnëret e caktuar për mbledhjen e mbeturinave që vendosen në tërë hapësirën e veprimit. Kontejnerët e përshtatshëm për hedhjen e mbeturinave i jepen shitësit.

Lavatoret

Pastrimi i urinaleve, toaleteve, lavatoreve, lavamaneve, dushave, mureve, dyerve, ndarjeve dhe të gjitha hapësirave tjera të lavatoreve, bëhet me lecka, shpuzë, lecka të lagura, brusha dhe pajisje të tjera që nuk përdoren më për asgjë tjetër, me detergjent dezinfektues. Lavatorja e larë mirë është ajo ku edhe hapësirat nën instalimet e ndryshme dhe të gjitha hapësirat e dukshme të jenë të pastruara. Të gjitha instalimet duhet të kenë pamje të pastër, pa vija dhe pamje higjienike. Pastruesit duhet gjithmonë të punojnë me doreza mbrojtëse.

Lustrimi i metalit

Lustrimi i metalit kryhet pas fshirjes së lagësht dhe kryhet duke shfrytëzuar një leckë të butë bashkë me mjetin përkatës për lustrim. Sipërfaqja e lustruar mirë është ajo ku nuk ka hapësira të nxira dhe mbeturinat e polirit dhe që ka shkëlqim të njësuar në çdo pjesë.

Pastrimi i mureve dhe i dyerve

Pastrimi i mureve përfshin: muret, shtyllat, ndarjet, dekorimet, radiatorët, tabelat, zbukurimet e ndryshme dhe instalimet në mure. Pastrimi i derës përfshinë: dyert, majat, anën (faqet) e dyerve dhe orenditë ose dekorimet në dyer. Pastrimi bëhet me anë të shpuzës së njomë ose leckës së zhytur në tretjen e detergjentit dhe dezinfektuesit. Sipërfaqet e pastrura mirë duhet të jenë të shndritshme, të mos kenë papastërti, myk, njolla, hapësira të nxira, ose të spërkatura. Dyert e mëdha në të gjitha hyrjet; zhveshtore, zyra, banjo, tualete, depo dhe hyrjet e brendshme që gjenden në Palestër.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet largimit të njollave dhe pikave të yndyrshme në hapësirat me qarkullim të madh dhe atje ku dyert shfrytëzohen shumë shpesh. Dera e pastruar mirë nuk duhet të ketë vija ose vende të papastra.

Pastrimi i xhamave dhe dritareve

Pastrimi i xhamave dhe pasqyrave. Xhamat dhe pasqyrat duhet të pastrohen me leckë dhe/ose me shpuzë të lagur në detergjent ose pastrues të xhamit. Kjo duhet të pasohet nga lustrimi, duke përdorur lecka të thara ose peshiqr letre. Buzët dhe kornizat ngjitëse po ashtu duhet të pastrohen dhe të lustrohen. Sipërfaqja e qelqit e pastruar mirë është ku nuk ka pluhur, papastërti, vaj, pika, vija ose mbeturina.

Pastrimi i dritareve

Pastrimi i dritave përfshin largimin e mbulesave të dritave dhe fshirjen brenda dhe jashtë të çdo mbulese, duke përdorur një leckë të lagur, instalimet flouroscente, përfshirë tubat (e neonit) dhe zbutësit e shndritjes, duhet të pastrohen lehtë dhe pluhuri ose njollat t'iu fshihen. Drita e pastruar mirë nuk duhet të përmbajë insekte, papastërti, pluhur dhe materie të tjera të jashtme, këtu hyn edhe pastrimi i perdeve.



Për pastrimin e dritareve të mëdha rreth palestrës ku duhet të përdoret vinçi, për shkak lartësisë së xhamave dhe perdeve të vendosura në Palestër.

Larja e tapeteve me shampon dhe pastrimi i tapicerive

Larja e tapetit (tepih) me shampon është proces i vendosjes së shamponit për tretje higjienike të fijeve të tapetit dhe shfrytëzimi i makinës ekstraktuese për larjen e tapetit.

Tapeti i larë mirë me shampon është ai që është pastruar në mënyrë të njëtrajtshme, sipas udhëzimeve të prodhuesit të shamponit të përdorur.

Tribunat

Pastrimi i ulëseve me shampon dhe me ujë të pastër, largimi i njollave, ngjyrave të ndryshme, pluhurit, pastrimi i korridoreve në mes ulëseve në tribuna dhe largimi i mbeturinave, rrethojat e tribunave, shkallët e tribunave, korridoret mbi ulëse të pastrohen dhe të largohen mbeturinat, njollat dhe ngjyrat e ndryshme.

Mbeturinat -pastrimi i mbeturinave në tribuna, parket, zhveshtore, tualete, banjo, zyrë, depo, korridor, shkallë, të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë dhe të hidhen në shporta më të afërta.

Pastrimet speciale shitesë

Menxaheri i kontratës nga ana e blerësit ose përfaqësuesi i tij/saj i autorizuar, mund t'i kërkojë kontraktuesit të kryejë shërbime në ndërtesë, para ose pas vendosjes së banorëve.

Këto shërbime kryhen dhe paguhen sipas çmimit të dakorduar për metër katror. Shërbimet përfshijnë si në vijim:

Hapësirat me tapete: shamponi me metodën e shkurës së tretur dhe largimi i njollave me kemikalie adekuate

Depot -Pastrimi i depove dhe mirëmbajtja e pajisjeve që gjenden në depo, larja e dyshemesë.

Xhamat/dritaret: pastrimi special i pasqyrave/xhamave/qelqit për të larguar njolla dhe shenja.

Dyshemeja: Larja mekanike e dyshemesë, vendosja e dyllit, lustrimi me materiale speciale për largimin e njollave të ushqimit dhe shenjave të tjera.

Mobilet: pastrimi special dhe lustrimi i i mobileve me tapiceri.

Guacat: Largimi i acideve urinore dhe njollave gëlqerore.

Muret: Larja/pastrimi i mureve dhe largimi i shenjave të gishtërinjve, njollave, etj.

Orari i punës

Shumë zyre dhe objekte janë të hapura 7 ditë në javë. Intervalet e pastrimit të çdo hapësire janë dhënë në listën shtojca B.

Në mënyrë që të mundësohet një ambient i pastër i punës, mund të pritet edhe pastrimi pas orarit normal të punës.

Për shkak të rritjes së sigurisë, mund të priten edhe ndërprerje në rutina ditore.

Kërkoheq që pastrimi i hapësirave të përbashkëta (korridoret, shkallët, sallat e mbledhjeve, të janë të pastruara para se të fillojë orari zyrtar i shfrytëzuesve të ndërtesës, pra para orës 08,00 të mëngjesit ditëve të punues, kështu që hapësirat tjera (zyret, sallat e mbledhjeve etj) të fillojnë punën nga ora 08,00.

Furnizuesi është përgjegjës për vegla, vegla motorike, të gjitha materialet për pastrim, pajisjet për fshirje, sigurim të punës, sigurim ndaj palës së tretë dhe uniformat e punës, pa përjashtim për secilin punëtor i cili kryen shërbime për punëkryesin gjatë tërë orarit të punës, varësisht prej sezonit. Nga bartja e uniformës së kompanisë mundet të lirohet vetëm menaxheri kryesor i kompanisë.

Shitësi i kryen të gjitha shpenzimet në përputhje me këtë marrëveshje dhe me Urdhërblertjen e Blerësit. Në rast se zgjerohet territori i përgjegjësisë, Urdhërblertja e posaçme me çmimet që do të pasqyrohen në këtë Marrëveshje afatgjatë do të bashkangjiten si ndryshim.

(Urdhërblertja lëshohet pasi të jetë emëruar kontraktuesi i suksesshëm).

Moskryerrja e shërbimeve në mënyrë kualitative.



Punëdhënësi ka të drejtë të aplikojë ndalesën e pjesshme të vlerës së kontraktuar me punëmarrësin për shërbimet e ofruara për cilëndo ndërtesë për arsyet të cilat do të vlerësohen si më poshtë:

- moskryerja e shërbimeve në tërësi apo pjesërisht, sipas cilësisë së nevojshme gjegjësisht të kërkuar,
 - zgjatja e afatit të kryerjes së punëve,
 - moskompletimin e stafit punues me kryes të mjaftuar,
- Mosrespektimi i mirësjelljes, orarit, qëndrimit ndaj punëve, qëndrimit ndaj shërbyesve civil, keqpërdorimi i vendit të punës.

Shtojca B

Kodet e intervalve:

D-SN	Çdo ditë sipas nevojës
D2	Dy herë në ditë
J	Një herë në javë
M	Një herë në muaj
M2	Çdo Dy muaj
M3	Çdo tre muaj
M6	Çdo gjashtë muaj
SN	Sipas nevojës

Vendet specifike

1.1 Toaletet, banjot dhe zheshtoret

Fshirja e dyshemeve.....	D-SN
Fshirja e dyshemeve me ujë të ngrohtë dhe dezinfektues.....	D-SN
Larja dhe dezinfektimi i toaleteve, dushemeve dhe lavamaneve.....	D-SN
Larja dhe dhe gërryerja me ujë të ngrohtë dhe sapun dezinfektimi i të gjitha urinaleve, vendosja e tabletave dezinfektues dhe plastikave, gomave të shpuara	D-SN
Larja dhe tharja e pasqyrave	J
Zbrazja e shportave për letra.....	SN
Larja dhe dezinfektimi i kontejnerëve të letrave.....	SN
Lustrimi i çesmeve (rubinetave) të ujit dhe të gjitha instalimeve nga kromi.....	SN
Larja e mureve, orendive nga druri, ndarjeve dhe dyerve.....	SN
Pluhurimi (pastrimi i pluhurit), parvazeve dhe ngrohësve.....	SN
Pluhurimi i poçeve dhe pllafoneve.....	M
Larja dhe tharja e dritareve (të mbrendshme dhe të jashtme.....	J
Vendosja e peshqirëve të letrës, letër toaletit, sapunëve dhe aromatikeve në urinale	D-SN

1.2 Korridoret, shkallët dhe hyrjet

Pastrimi i tapeteve (tepihëve) me fshesë elektrike pa zhurmë.....	D-SN
Tapeti vazhdimisht krijon pluhur dhe ka nevojë të dezinfektohet vazhdimisht dhe t lahet me makina profesionale	D-SN
Fshirja e korridoreve dhe pastrimi i tyre me leckë të njomë	D-SN
Pastrimi i sipërfaqeve me leckë të lagur (sipërfaqet e forta përveç atyre të drunjtja).....	M
Pastrimi i dyshemeve me leckë të njomë	D-SN
Pastrimi i dyerve, dorezave dhe tabakëve të xhamit.....	D-SN
Lustrimi i instalimeve nga mesingu dhe shenjave.....	J
Fshirja e pluhurit për pikturat, tabelat e shpalljeve, shenjave dhe mobileve	SN
Fshirja e pluhurit nga parvazet e dritareve, mureve, pllafoneve	
Gypave, tablllove dhe dritareve.....	J
Larja dhe tharja e dritareve (brenda dhe jashtë)	J



Larja e tapeteve me shampon	SN
Larja e tapeteve me shampon, në kohën e sezonës së garave sportive, (gjatë kampionatit)	D-SN
Larja e mureve, dyerve dhe orendive nga druri	M
Pastrimi i njollave në mure, dyerve nga druri dhe tapeteve.....	SN
Zbrazja e shpuzoreve dhe kontejnerëve dhe të mbeturinave.....	SN
Hedhja e pakove, mbështjellësve dhe mbeturinave të tjera nga zyret.....	D
1.3 Zyret dhe sallat e konferencave	
Zbrazja dhe pastrimi i shportave të letrave dhe shpuzoreve.....	D-SN
Fshirja dhe pastrimi i dyshemeve me leckë (përveç atyre të drurit).....	D-SN
Pastrimi i dyshemeve me leckë të lagur.....	D-SN
Pastrimi i dyshemeve të drurit me leckë të njomë.....	D-SN
Pastrimi i tapeteve me fshesë elektrike pa zhurmë.....	SN
Pastrimi i pluhurit në të gjitha mobilet, parvazet e dritareve, pajisjet/makinat për zyrë dhe ngrohësit....	J
Pastrimi dhe dezinfektimi i telefonave, kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera	J
Pastrimi nga pluhuri i dritareve, mureve, orendive nga druri, pllafoneve, gypave dhe tablllove/dyerve, tablllove dhe dritave	J
Larja dhe tharja e dritareve (të brendshme dhe të jashtme).....	M2
Larja e tapeteve me shampon.....	SN
Larja e mureve, dyerve dhe orendive nga druri.....	SN
Larja e mobileve.....	SN
Pastrimi i njollave nga tapiceria e mobileve.....	SN
Pastrimi i njollave nga të gjitha muret dhe orenditë e drurit.....	SN
Pastrimi i njollave në tapete.....	SN
1.4 Hapësirat e punëtorëve	
Fshirja dhe pastrimi i pluhurit me leckë në dysheme.....	D
Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë.....	D
Fshirja e pluhurit nga mobilet, tablllove dhe dritave.....	J
Pastrimi sipas nevojës i mureve dhe orendive të drurit.....	SN
Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë.....	D- SN
1.5 Hapësira të tjera	
Mirëmbajtja e hapësirës me gjelbrim dhe ujitja e barit dhe drunjve dekorative dhe pastrimi e larja, kubëzat që gjenden jashtë objektit të palestrës	SN
Pastrimi i depove dhe mirëmbajtja e pajisjeve që gjenden në depo, larja e dyshemesë	J
Pastrimi dhe mirëmbajtja e parketit.....	D-SN
Lokalet që janë të pa shfrytëzuara duhet të pastrohen dhe të lahen sipas nevojës.....	M3
Gjatë zhvillimit të garave dhe kampionatit	SN
Pastrimi i tribunave	D-SN
Pajisjet sportive	
Pastrimi i samaforëve, kornizat e koshave, shtyllat e volejbollit dhe rrjetat.....	J
Ndriçimi	
Pastrimi i poçave kryesor dhe zyreve, korridoreve, banjove, tualeteve	M2
Mjetet e forta dhe metalike	
Pastrimi i rrethojave të tribunave, muret e brendshme dhe të jashtme , pjesës së kulmit dhe rrethojat..	M



Shtojca C

2.1 Materialet për pastrim

Materialin harxhues duhet ta sigurojë vetë kompania.

I tërë materiali duhet të jetë i kualitetit të lartë dhe klasit të parë, para se të vendoset në objekte për çdo pozicion duhet të merret miratimi me shkrim nga investitori.

Minimumi i materialeve të nevojshme për pastrim:

- Letër toaleti, dyshtresore e bardhë e kualitetit të lartë
- Letër për duar e trashë, e bardhë, e gjërë (dyfishi i tualet letrës) e kualitetit të lartë
- Sapun të lëngshëm
- Deodorant për urinale, tableta dezinfektuese, plastika – goma të shpuara,
- Sapun deodorant (përfshirë edhe shportën) për guaca
- Dezinfektues të toaleteve
- Doreza plastike për pastruesit
- Detergjent për pastrimin e dritareve
- Detergjent për pastrimin e dyshemesë
- Detergjent për pastrimin e tapeteve (tepihëve)
- Qeska për shportat e mbeturinave
- Qeska për shportat e letrave
- Deodorant për kabinete, zyrë, salla
- Detergjent për pastrimin e pllakave
- Kova për pastrimin e dyshemesë
- Makina për pastrim dhe lustrim të pllakave të mermerit - granitit
- Fshesë elektrike pa zhurmë me pjesët përbërëse
- Brusha të ndryshme,
- Vegla të tjera për pastrim
- Lecka për pastrimin e dyshemesë
- Sfungjerë (shpuzë)
- Lecka për pastrimin e dritareve dhe mobileve
- Shkëlqyes për mobile
- Shkëlqyes për metal dhe mesing
- Lecka për pastrimin e dritareve
- Kruajtëse për dritare dhe dysheme
- Shkëlqyes për dysheme
- Detergjent për qeramikë
- Detergjent për heqjen e njollave
- Furça për çpluhurosje (pastrimin e pluhurit)
- Furça për dysheme
- Pajisje për pastrimin dhe sipas nevojës, për lajen e fasadave të ndryshme të ndërtesave



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturru, Omladinu i Sport

**PERSHKRIMI I ÇMIMEVE : MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE KULTURORE DHE PALESTRES
SPORTIVE ‘MIZAHIR ISMA ‘ NË RAHOVEC**

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Sipërfaqet e hapsirave të mbrendshme, duke përfshirë të gjitha hapsirat përcejellëse	M2	4233.53	0.15	635.03
2	Mirëmbajtja dhe pastrimi i Muzeut të UÇK-së, në Drenoc sipërfaqja e mbrendshme dhe e jashtme.	M2	600	0.10	60.00
3	Sipërfaqet e jashtme – shkallët e jashtme	M2	75	0.10	7.50
4	Sipërfaqet e jashtme – sipërfaqet e oborrit me kubëza	M2	1280	0.15	192.00
5	Mirëmbajtja dhe pastrimi i Muzeu i Maskres në Krushë të Madhe sipërfaqja e mbrendshme dhe e jashtme.	M2	1898	0.20	379.60
6	Sipërfaqet e gjelbruara	M2	170	0.20	34.00
Totali:					1,308.13

Çmimi duhet të jetë konformë të gjitha tatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës

